

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË RROGOZHINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Rrogozhinë, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.09.2013 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Drejtorit të Departamentit dhe Kryeaudituesit të Departamenti nr. 40, datë 25.04.2016

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1193/11 datë 25.04.2016, i ka rekomanduar z. Beqir Nuredini, Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi :Bashkia Rrogozhinë nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për detyrat e lëna nga KLSH, me shkresën nr.1128/84 prot, datë 27.03.2015 në auditin e mëparshëm, në drejtim të masave të rekomanduara për shpërblim dëmi, për 8 masa me vlerë **5,370,986 lekë** , 3 masa organizative në vlerën **21,225,465 lekë**.

Rekomandim : Të merren masa të menjëhershme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **5,370,986 lekë për 8 masa shpërblim dëmi, si dhe arkëtimin e vlerës 21,225,465 lekë** të subjekteve debitore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi : Nuk ishin hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit, si edhe nuk janë ndjekur dhe nuk ka raportime tek titullari i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave të njësisë vendore. Në rregullore nuk janë përfshirë elementet e kodit etik. Mungon programi i trajnimeve për punonjësit e kësaj njësie.

Rekomandim : Bashkia Rrogozhinë të marrë masa që të zbatojë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin si: mjedisit të kontrollit, menaxhimit të i riskut, veprimtaritë e kontrollit, duke synuar vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, informacionit dhe komunikimit si dhe monitorimit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10926, datë 08.7.2010.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Mungojnë programe të plota financiare afatmesme (PBA) dhe të pa miratuara në Këshillin Bashkiak në kundërshtim udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave nr.9/1 datë 25.02.2013, nr.7/1 datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”. Programet buxhetore vjetore janë paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak thjesht, duke përshkruar të dhënat tabelore, pa një analizë të hollësishme të detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm, me një planifikim të pastudiuar dhe të fryrë pa bazë reale të të ardhurave dhe shpenzimeve. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të buxhetit të paraqitura pranë Këshillit të Bashkiak si dhe analiza faktoriale e treguesve të realizimit të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit faktik të

miratuar nga Këshilli Bashkiak. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 101,254,255 dhe me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar, neni 19.

Rekomandim : Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit të zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe atij vjetor të mirëstudiuar, hartimin dhe planifikimin e treguesve, të bazuar mbi hartimin më parë të planit strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë realizuar prokurime me vlera të vogla për blerjen e artikujve e shërbimeve si dhe të grup-artikujve e grup-shërbimeve për:

- **Ish-Komunën Kryevindh** në 16 raste në shumën 3,497,244 lekë.
- **Ish-Komunën Lekaj** në 27 raste në shumën 2,761,485 lekë.
- **Ish-Komunën Gosë** për vitin 2014 në 16 raste në shumën 3,958,560 lekë dhe për vitin 6-mujorin e parë të vitit 2015 në 7 raste në shumën 1,492,360 lekë.
- **Bashkinë Rrogozhinë** për vitin 2014 në 26 raste në shumën 3,335,396 lekë dhe për vitin 2015 në 69 raste në shumën 17,101,232 lekë, ku u konstatuan mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: Nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet testimit të tregut; mungon në disa raste dokumenti i kualifikimit final të shkarkuar nga faqja e APP, në rastet riparimeve të automjeteve mungon akt-konstatimi i defekteve nga specialiste të fushës për përcaktimin e nevojës për riparim, mbi bazën e së cilës do të përcaktohej dhe fondit limit; në disa raste mungon dokumenti i QKR nga OE në kundërshtim me kriteret e kualifikimit, mungon akti i marrjes në dorëzim i mallrave dhe punimeve në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40, me Udhëzimin e APP nr.2. datë 28.03.2013 dhe nr.03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr.33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 37 dhe rubrika “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara” pika 42,43 e 44.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për vendosjen e rregullave për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave e përcaktimit të nevojave, përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës deri në përfundimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e dokumenteve të plota ligjore financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa në 28 raste në shumën 2,232,240 lekë për blerje mallrash e shërbimesh në bazë faturash të lëshuara nga biznesi i vogël, të cilat nuk janë sipas formatit të saktë tatimor në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe UMF nr.24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar pika 46.1.3 ,46.1.4,46.1.5, me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”neni 4 pika 26 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, pika 35,36 si dhe me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”neni 40, pika 7.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Komisionit prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të marrë masa, që për blerje mallrash e shërbimesh të mos pranojë dhe të mos kryejë pagesa për blerje mallrash e shërbimesh mbi bazën e faturave jo sipas formatit të saktë tatimor, detyrim ligjor për shmangien e fiktivitetit si dhe të evazionit fiskal.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2015 janë kryer pagesa për blerje për 9 lloje grup-mallrash e grup-shërbimesh me procedurën e prokurimit me vlera të vogla në rrugë shkreore sipas formularit 5 në vlerën jo më të madhe se 100,000 lekë pa TVSH, kur vlera e tyre brenda vitit është më e madhe se 100,000 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 8. Kështu për zërat: Shpenzime mirëmbajtje ndërtesa në 9 raste në shumën 860,098 lekë; Riparim mirëmbajtje për kanale në 12 raste në shumën 1,166,791 lekë;Transport Futbollistësh në 2 raste në shumën 164,900 lekë;Transport nxënësish në 13 raste në shumën 2,015,250 lekë; Punime të ndryshme në 4 raste në shumën 378,922 lekë;Materiale dekori në 4 raste në shumën 334,950 lekë;Materiale elektrike në 2 raste në shumën 149,380 lekë;Riparime e pjesë këmbimi në 6 raste në shumën 388,600 lekë;Orendi zyre në 2 raste në shumën 205,716 lekë.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nëpërmjet komisionit prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të marrë masa që në asnjë rast, të mos prokurojë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor. Prokurimin me vlera të vogla nuk duhet ta shohë si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe shmangien e procedurave konkurruese e normale të prokurimit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në dy raste rezultoi se : Në tenderin me objekt “Blerje karburant 2014, për Bashkinë Rrogozhinë ” si dhe tenderin “Blerje karburant 2015, për Bashkinë Rrogozhinë ”,përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë nga i njëjti punonjës që është njëkohësisht kryetar i KVO-së në kundërshtim me VKM nr.1,datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik ", i ndryshuar, Kreu V, pika 2(a).

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet Titullarit në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të

përcaktojë në mënyrë të saktë komisionet e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit si dhe atij të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të shmangët konflikti i interesit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Taksave në Bashki nuk është hartuar dhe miratuar plan kontrolli të subjekteve private të biznesit si dhe nuk janë ushtruar kontrole ndaj tyre në lidhje me mbajtjen e saktë të librave, mbajtjen e xhiros, kuponët e kasës fiskale në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10, “Kontrolli tatimor”. nenin 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Rekomandim : Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në Bashkinë Rrogozhinë të merren masa për hartimin e planit vjetor të kontroleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave nenin 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Rrogozhinë, nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, **22 subjekte**, të cilët që nga viti 2013 ushtrojnë aktivitetin pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksat vendoren kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke sjellë mungesë të ardhurash për vlerën 607 160 lekë. Për këto subjekte nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për detyrimin e licencimit të tyre dhe pagesën e taksave vendore në kundërshtim me në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”.

Rekomandimi : Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet Zyrës së Taksave të marrë masa, që për **22** subjektet e evidentuara si të palicensuara, të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Bashkisë, për **vlerën gjithsej 607 160 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlere.

Deri më datë 31.12.2016

15. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Rrogozhinë në datën 31.12.2015 gjendja e debitorëve për popullatën për 4 llojet e taksave të tokës, banesës, të pastrimit e ndriçimit, të gjelbërimit paraqitet në vlerën 7,406,635 lekë.

Rekomandimi : Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet Zyrës së Taksave të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë për 4 llojet e taksave të popullatës të pa likuiduara deri më datën 30.9.2016 në vlerën 7,406,635 lekë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi : Në Bashkinë Rrogozhinë, përveç VKM për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim nuk administrohet asnjë dokumentacion tjetër mbi përputhshmërinë e procesit të inventarizimit dhe kalimit të pronësisë si dhe të

inventarizimit të tokave bujqësore. Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë asnjë aplikim në ZVRPP Kavajë për regjistrimin e pronave si të ish-Bashkisë Rrogozhinë ashtu dhe të ish-komunave të shkrira, Lekaj, Kryevindh, Sinaballaj. Rezulton gjithashtu se në ish-komunën Gosë, procesi i kalimit të pronësisë nuk ka përfunduar, ka mbetur në fazën e miratimit të listës paraprake. Në ish-Bashkinë Rrogozhinë, në listën përfundimtare të pronave publike, shtetërore, të miratuar me VKM nr. 624, datë 7.9.2011, ekzistojnë prona të llojit truall, në zonën kadastrale 3234, shesh i lirë, me sipërfaqe totale prej 168,648 m² që i shërben privatit, e përcaktuar nga komisioni gjatë inventarizimit, në rubrikën ‘funksioni për të cilën përdoret prona’ të cilat shfrytëzohen nga privatët jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, në forma ligjore të njohura dhe veçanërisht asaj të dhënies me qira, të cilat, referuar çmimit minimal të dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pronat, truall i lirë, sipas aneksit nr.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, do të gjeneronin të ardhura për Bashkinë në shumën totale prej **440,191,200 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë për periudhën objekt i auditimit. Në përfundim të auditimit rezulton se Bashkia Rrogozhinë, e përbërë nga ish-Bashkia Rrogozhinë dhe ish-komunat Lekaj, Kryevindh, Sinaballaj dhe Gosë, nuk ka nën kontroll situatën në lidhje me asetet e paluajtshme që ka në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të të drejtave të pronësisë apo përdorimit, kryerjes jo në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontrolleve dhe saktësisë të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion.

Rekomandim: Të ngrihet një grup pune i përbërë nga specialistë të fushës, ku të përfshihen dhe specialistë të ish-komunave të shkrira, i cili në bazë të një strategjie sektoriale dhe një plani masash konkrete dhe me afate të përcaktuara të analizojë situatën e aseteve dhe të fillojë menjëherë punën për:

1. Përfundimin e procesit të kalimit të pronave nga shteti në njësinë administrative, ish-Komuna Gosë, nëpërmjet shfrytëzimit të rrugëve ligjore për miratimin e listës përfundimtare të pronave që kalojnë në pronësi të njërive të pushtetit vendor.
2. Mbështetur në praktikën e aplikimit dhe regjistrimit të truallit dhe objektit ku ushtron funksionet administrative Bashkia Rrogozhinë gjatë ushtrimit të auditimit atje, të vazhdojë me ritme të shpejta përgatitja e dokumentacionit të kërkuar dhe aplikimi i njëpasnjëshëm për regjistrimin sa më shpejt të pronave që i kanë kaluar Bashkisë Rrogozhinë, së bashku me njësitë administrative, si dhe të verifikohet situata e pronave në bashkëpunim me ZVRPP dhe Agjencinë e ALUIZNIT për ndërtime të mundshme pa leje në pronat që i kanë kaluar bashkisë dhe që mund të jenë futur në proces legalizimi dhe, në rast se evidentohen situata të tilla, të kërkojë në rrugë ligjore rivendosjen e të drejtave të pronave në interes të bashkisë.
3. Identifikimin e gjurmës së pronave në terren, përcaktimit të kufijve dhe statusit të tyre si dhe identifikimin e tokave bujqësore të pandara në territorin nën juridiksion të bashkisë dhe njërive administrative me qëllim shfrytëzimin e këtyre burimeve në interes të bashkisë në formën e dhënies me qira.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Rrogozhinë, janë grumbulluar nga ish-Bashkia Rrogozhinë dhe ish-Komunat Kryevindh, Lekaj, Gosë dhe Sinaballaj, aktualisht njësi administrative të Bashkisë Rrogozhinë, dokumentet e prodhuara nga këto të fundit, përpara datës 1 janar 2015, jo në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu V, pika 4, pasi, dokumentet, dhe në këtë kuadër, pasqyrat financiare që përfshijnë tërësinë e aktivitetit të tyre deri në datën e fundit të funksionimit, nuk janë dorëzuar me procesverbal pas verifikimit dhe kontrollit fizik të tyre. Nga auditimi është konstatuar gjithashtu se për aktivet e trupëzuara në tërësinë e tyre, Bashkia Rrogozhinë, duke mos siguruar gjurmët e dokumentacionit kontabël si dhe duke mos patur të regjistruar në ZVRPP, Kavajë, pronësinë ligjore mbi aktivet e trupëzuara, nuk jep garanci të arsyeshme mbi vlerën reale të tyre dhe përputhshmërinë me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar, Kreu III, neni 9, pika 1, mbështetur në 1, shpallur me UMF nr. 64, datë 22.7.2014, paragrafi 17, “Bazë për raportimin e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar është ekzistenca e pronësisë ligjore ose ekzistenca e kontrollit efektiv. Ndonëse në përgjithësi, kontrolli efektiv i aktiveve përputhet me pronësinë ligjore të tyre, kjo mund të mos ndodhë gjithmonë. Për shembull, në rastin e një marrëveshjeje për qira financiare një aktiv mund ti përkasë ligjërisht qiradhënësit, por meqenëse ky aktiv është nën kontrollin e qiramarrësit për pjesën më të madhe të jetës së dobishme të tij, ai raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar të qiramarrësit” pasi mbi aktivet e trajtuara në procesverbalin nr. 2, datë 12.02.2016, Bashkisë Rrogozhinë, i mungon pronësia ligjore, por më e rëndësishmja, kontrolli efektiv mbi to.

Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme, në kuadër dhe të procesit të konsolidimit të pasqyrave financiare pas shkrirjes së ish-komunave e bashkive, pas zgjedhjeve të vitit 2015, për sigurimin e dokumentacionit të duhur kontabël të aseteve që kanë kaluar në pronësi të bashkisë si dhe të saktësojë, nëpërmjet vlerësimit dhe rivlerësimit nëse nevojitet, vlerën reale të aktiveve të trupëzuara të institucionit dhe sigurimin në këtë mënyrë të përputhshmërisë me SKK në raportimin e pasqyrave financiare për aktivet e trupëzuara.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor të kësaj njësie nuk ka punuar me plane pune mujore, 3 mujore apo vjetore në kundërshtim me VKM nr.862, date 05.12.2007 “ Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor, germa b(ii). Kjo ka ndodhur pasi prej Bashkisë Rrogozhinë nuk është miratuar në strukturë pozicioni i Kryeinspektorit në kundërshtim me nenin 45 të Rregullores së Brendshme të Administratës së Bashkisë Rrogozhinë.

Rekomandim : Bashkia Rrogozhinë të marrë masa që në miratimet e Strukturës organike të Bashkisë të përcaktojë në mënyrë të plotë strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, në përputhje me duke përfshirë Kryeinspektorin në përputhje me Rregulloren e Brendshme dhe VKM nr.862, date

05.12.2007 “ Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor, gërma b(ii), me qëllim realizimin e funksionit të kësaj strukture në kuadër të realizimit të objektivave të Bashkisë.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet urdhrit nr.37, datë 11.09.2014 ka ngritur një komision të posaçëm për verifikimin e objekteve pa leje, të ngritura në territorin nën juridiksionin e saj. Nga komisioni është mbajtur një relacion përmbledhës me shkresë nr.740 prot, datë 15.10.2014, ku paraqiten objektet e ndërtuara pa leje. Për këto objekte pa leje nuk janë mbajtur procesverbale në momentet e identifikimit në kundërshtim me VKM nr.862, date 05.12.2007 “ Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”, neni 15 pika 4 dhe Rregullores së Brendshme, neni 46. Ndaj shkelësve nuk është marrë **asnjë vendim me gjobë, apo vendim për pezullimin e punimeve** në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar neni 5“ Detyrat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore”, pika (b) dhe pika (ç), ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “ Për urbanistikën”, i ndryshuar neni 76.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet IMTV-së në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa për evidentimin e objekteve të ndërtuara pa leje brenda juridiksionit të Bashkisë Rrogozhinë si dhe në njësitë administrative të cilat i janë bashkangjitur kësaj Bashkie.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit **në vlerën prej 5,660,962 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime për sportin në favor të Futboll Klub “Egnatia” Rrogozhinë për pagesa për premio përkatësisht në shumën 273,200 lekë për 4-mujorin e tretë të vitit 2013, në shumën 392,400 për vitin 2014 dhe në shumën 582,250 lekë për vitin 2015 për lojtarë të futbollit të cilët nuk janë të federuar në kundërshtim me ligjin nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” të ndryshuar me ligjin nr.9816, datë 22.10.2007 dhe ligjit nr. 9963, datë 21.7.2008, neni 3, pika 16 , neni 23/1 dhe me Statutin e Federatës Shqiptare të Futbollit Kreu I “Përcaktimi i termave”,

ku thuhet se: “Lojtar”: do të nënkuptojë një futbollist të regjistruar në FSHF”, neni 4 dhe 54, me pasojë dëmin ekonomik 1,248,250 lekë.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës 1,247,850 lekë të përfituar padrejtësisht sipas shumave përkatëse nga personat e paguar si sportiste të pa federuar sipas aneksit nr.1.

Brenda vitit 2016

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në shumën 740,400 lekë OE “B.T.” për shërbim interneti për Bashkinë Rrogozhinë, ku blerja e këtij shërbimi është bërë *pa procedurë prokurimi* në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” neni 1/a,3/4,4,12 dhe VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu I pika 1 dhe 3/b, dhe me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu është parashikuar në kontratë dhe faturuar për çdo muaj vlera e mirëmbajtjes së linjave të internetit dhe kabllorë, e cila duhet të ishte pjesë e çmimit të shërbimit të linjës, pasi për çdo përdorues ka një linjë më vete dhe pagesë më vete. Shuma prej 60,000 lekë e paguar për zërin “mirëmbajtje rrjeti” është mbishpenzim i pajustificuar, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 60,000 lekë.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës 60,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga OE “B.T.” për zërin “mirëmbajtje rrjeti” në shërbimin e internetit. Të shikohet mundësia e rishikimit të kontratës për heqjen e këtij zëri të shtuar tepër, nëse nuk është e mundur, të anulohet kontrata dhe të zhvillohen procedurat e prokurimit për këtë shërbim.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbështetës të veprimeve të kryera nëpërmjet bankës nga ish- Komuna Gosë rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa OE fitues “E...” shpk për shërbimin e pastrimit të mbeturinave urbane në bazë të kontratës nr.prot.02, datë 02.04.2012 me afat 5-vjeçar për periudhën 02.04.2012-31.03.2017 me vlerë për vitin e parë 1,741,000 pa TVSh, situacioni vjetor Prill 2013-Mars 2014 me vlere 1,732,000 lekë. Me datë 01.04.2014 është lidhur një aneks kontratë me vlerën 2,089,200 lekë pa tvsh, vlerë e rritur e paargumentuar mbi bazën e së cilës janë situacionuar periudhat vjetore Prill 2014-Mars 2015 dhe Prill 2015-Mars 2016 me rritje të sasisë së mbeturinave dhe të sipërfaqeve të mirëmbajtjeve dhe gjelbërimit. Preventivimi, miratimi i situacioneve dhe pagesa e vlerës së zërit të shërbimit “Transport mbeturinash me automjet vetëshkarkues nga komuna në vend-depozitim distance 10 km” të situacioneve me një çmim më të lartë se çmimi zyrtar i miratuar të manualeve të punimeve ndërtimit të viteve 2012 dhe 2013 dhe pagesa e vlerës së volumeve dhe sipërfaqeve të rritura në mënyrë të pa argumentuar është në kundërshtim me kontratën bazë nr.prot.02, datë 02.04.2012, neni 17 “Ndryshimet e kontratës”, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” Kreu II, pika 2/(c), me ligjin 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 12 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 36, me pasojë dëmin ekonomik në shumën totale prej 2,011,000 lekë.

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej 2,011,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga OE "E...A" nga ofertimi dhe situacionimi i vlerës së zërit të shërbimit "Transport mbeturinash me automjet vetëshkarkues nga komuna në vend-depozitim distance 10 km" me çmim më të lartë se çmimi zyrtar i miratuar dhe nga pagesa e vlerës së volumeve dhe sipërfaqeve të rritura në mënyrë të pa argumentuar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së lidhur nr.268 prot, datë 07.04.2015 nga prokurimi me objekt "Blerje karburant 2015, për Bashkinë Rrogozhinë" rezultoi se nga OE fitues "M...K" sh.p.k ka mbetur pa u lëvruar sasia prej 2081 litra deri më datë 31.12.2015 afati i fundit i kontratës në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të kontratës Kreu I "Fillimi i zbatimit dhe mënyra e lëvrimit", neni 7; neni 22.5. dhe neni 23 "Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar", *me pasojë penalitetin e përllogaritur prej 74,461 lekë [(0.002*128 ditë)*290,864 lekë].*

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës së penalitetit prej 74,461 lekë nga Shoqëria "M...K", nga mos furnizimi me sasinë e mbetur karburantit të kontraktuar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në librin e magazinës rezultoi se prej ish Komunave është bërë hyrje një sasi prej **5350 litra** karburant, duke plotësuar kështu të gjitha nevojat e parashikuara në kontratën nr.268 prot, datë 07.04.2015, për përllogaritjen dhe lëvrimin e karburantit për vitin 2015. Më datë 10.11.2015, Bashkia Rrogozhinë ka blerë me procedurën e prokurimit me vlera të vogla sasinë prej **5160 litra naftë**, kur magazina kishte gjendje në kundërshtim me ligjin nr.9643, "Për Prokurimin Publik", datë 20.01.2006 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke kryer mbi shpenzim të pa justifikuar *me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 873,072 lekë.*

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **873,072 lekë** nga z. B.N. në funksionin e Kryetarit të AK dhe në cilësinë e nënpunësit autorizues për blerje të karburantit mbi nevojat, për të cilat nuk ka asnjë dokument mbi përllogaritjen dhe argumentimin e tyre.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë ka paguar më tepër në vlerën 13288 lekë në 2 raste shoqërinë "M...K" sh.p.k për furnizimin e 1000 litra karburant me Urdhër Shpenzimin nr.303, datë 20.08.2015 me çmim për litër më tepër se çmimi i ofertës në vlerën 12,340 lekë dhe 1200 litra karburant me Urdhër Shpenzimin nr.302, datë 20.08.2015 me çmim për litër më tepër se çmimi i bursës në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Kreu IX, neni 77, pika 5 si dhe neni 23, Kushtet e Përgjithshme, me pasojë dëmin ekonomik në shumën **13,288 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat, që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **13,288 lekë** prej

subjektit “M...K” përfituar tepër si rezultat i ndryshimit të çmimit për litër në dy furnizime.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Operatori ekonomik “M...K” sh.p.k bazuar në kontratën me nr.467 prot, datë 11.06.2014 ka lëvruar karburant jo në përputhshmëri me çmimet e bursës *REUTERS*, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, Pika 2, Germa c, **me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 37,101 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 37,101 lekë nga subjekti “M...K” përfituar tepër si rezultat i ndryshimit të çmimit për litër të faturuar nga çmimi i bursës.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në list-pagesat e Këshillit Bashkiak rezultoi se janë paguar Këshilltar edhe kur ata nuk kanë qenë pjesëmarrës në mbledhjet e Këshillit, Sekretari i Këshillit z.E.SH. nuk ka njoftuar Prefektin për mos aktivizimin e Këshilltarëve në mbledhjet e Këshillit Bashkisë deri në 6 muaj për vitin 2013, 2014. Gjithashtu nga Sekretari i Këshillit nuk janë dërguar pranë Sektorit të Financës list-prezencat e pjesëmarrjes të këshilltarëve në mbledhje, sipas të cilave do të kryheshin pagesat e tyre, ku si rrjedhojë kanë përfituar shpërblim page të tepërta dhe këshilltarët që nuk kanë frekuentuar mbledhjet në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31,pika 2 dhe pika 8, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 1,343, 790 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës prej 1 343 790 lekë përfituar padrejtësisht nga këshilltarët për mos marrje pjesë në mbledhje sipas listës në aneksin nr.5.

Brenda vitit 2016

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “*Llojet e masave disiplinore*” dhe 59 “*Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe në nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ***i rekomandojmë Titullarit pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore Bashkisë Rrogozhinë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të klasifikojë shkeljet e konstatuara, në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojnë ecurinë disiplinore per marrjen e masave disiplinore, që nga masa “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit që mardhëniet e punës rregullohen me Statusin e Nëpunësit Civil. Ndërsa për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas***

Kodit të Punës rekomandojmë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”,si më poshtë:

1. **z.F.M.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e Kryetarit të KPVV (për periudhën 01.07.2013-31.08.2015)
2. **z.L.H.** me detyrë Inspektor Taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV (për periudhën shtator 2013-korrik 2015)
3. **z.A.K.** me detyrë Inspektor-llogaritar, me detyrë inspektor taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV
4. **z.B.P.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse dhe në cilësinë e Kryetarit të KPVV(për periudhën 04.08. 2015-31.12.2015)

- Për mangësitë e konstatuara në plotësimin e dokumenteve pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si Nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet testimit të tregut; mungon në disa raste dokumenti i kalifikimit final të shkarkuar nga faqja e APP, në rastet riparimeve të automjeteve mungon akti konstatimit të defekteve nga specialiste të fushës dhe përcaktimin e nevojës për riparim mbi bazën e së cilës do të përcaktohej dhe fondit limit;në disa raste mungon dokumenti i QKR nga OE, mungon akti i marrjes në dorëzim mallrave dhe punimeve në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”neni 40, me Udhëzimin e APP nr.2. datë 28.03.2013 dhe nr.03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr.33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 37 dhe rubrika “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara” pika 42,43 dhe 44.

- Për pagesa në 28 raste në shumën 2,232,240 lekë për blerje mallrash e shërbimesh në bazë faturash të lëshuara nga biznesi i vogël, të cilat nuk janë sipas formatit të saktë tatimor në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe UMF nr.24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar pika 46.1.3 ,46.1.4,46.1.5,

- Për pagesa për blerje për 9 lloje grupmallrash e grupshërbimesh për vitin 2015 me procedurën e prokurimit me vlera të vogla në rrugë shkresore sipas formularit 5 në vlerën jo më të madhe se 100,000 lekë pa TVSH, kur vlera e tyre brenda vitit është më e madhe se 100,000 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”

- Për pagesat e kryera në shumën 740,400 lekë OE “B.T.” për shërbim interneti për Bashkinë Rrogozhinë, ku blerja e këtij shërbimi është bërë pa procedurë prokurimi në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”neni 1/a,3/4,4,12 dhe VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”Kreu I pika 1 dhe 3/b,dhe me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu është parashikuar në kontratë dhe faturuar për çdo muaj vlera e mirëmbajtjes së linjave të internetit dhe kabllore, e cila duhet të ishte pjesë e çmimit të shërbimit të linjës, pasi për çdo përdorues ka një linjë

më vete dhe pagesë më vete. Shuma prej 60,000 lekë e paguar për zërin “mirëmbajtje rrjeti” është mbishpenzim i pajustificuar, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 60,000 lekë.**

5. z.P.H. në funksionin e Përgjegjës të Futboll Klub “Egnatia” Rrogozhinë.

- Për hartimin e listepagesave për pagesa për premio në favor të Futboll Klub “Egnatia” Rrogozhinë përkatësisht në shumën 273,200 lekë për 4-mujorin e tretë të vitit 2013, në shumën 392,400 për vitin 2014 dhe në shumën 582,250 lekë për vitin 2015 për lojtarë të futbollit të cilët nuk janë të federuar në kundërshtim me ligjin nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” të ndryshuar me ligjin nr.9816, datë 22.10.2007 dhe Ligjit nr. 9963, datë 21.7.2008, neni 3, pika 16 , neni 23 /1 dhe me Statutin e Federatës Shqiptare të Futbollit Kreu I “Përcaktimi i termave”, ku thuhet se: “Lojtar”: *do të nënkuptojë një futbollist të regjistruar në FSHF*”, neni 4 dhe 54, **me pasojë dëmin ekonomik 1,248,250 lekë.**

6. z.SH.D. me detyrë Jurist në Ish-komunën Gosë dhe aktualisht në Njësinë Administrative Gosë, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT)

7. z.G.E. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës në ish-Komunën Gosë dhe aktualisht specialist finance në Njësinë Administrative Gosë

- Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës si dhe pagesën për shërbimin e pastrimit të mbeturinave urbane të vlerës së zërit të shërbimit “Transport mbeturinash me automjet vetëshkarkues nga komuna në vend-depozitim distance 10 km” të situacioneve me një çmim më të lartë se çmimi zyrtar i miratuar të manualeve të punimeve ndërtimit të viteve 2012 dhe 2013 dhe pagesa e vlerës së volumeve dhe sipërfaqeve të rritura në mënyrë të pa argumentuar është në kundërshtim me kontratën bazë nr.prot.02, datë 02.04.2012, neni 17 “Ndryshimet e kontratës”, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” Kreu II, pika 2/(c), me ligjin 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 12 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 36, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën totale prej 2,011,000 lekë.**

8. z.Z.K. në cilësinë e Inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor

9. z.A.T. në cilësinë e Inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor

10. z.B.D. në cilësinë e Inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor

Nga auditimi i kryer në IMTV e Bashkisë Rrogozhinë rezultoi se kjo njësi nuk ka kryer identifikimin e saktë të objekteve të ndërtuara pa leje për periudhën 2013-2015, në përputhje me VKM nr.862, date 05.12.2007 “ *Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor*”, pika 4 ku thuhet se : Kryeinspektori/inspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik vendor, pas kontrollit në objekt, mban procesverbalin, ku pasqyrohen

gjendja aktuale , mangësitë dhe detyrat për subjektin ndërtues,si dhe zbaton procedurat ligjore për shkeljet e vëna re, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit”, nen i cili shprehet se: “...Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbatjtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga Kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar....”. Sa më sipër mos mbajtja e procesverbaleve gjatë çdo kontrolli ka sjellë mos marrjen e masave administrative kundrejt shkelësve të legjislacionit në fuqi, veprim i cili përbën kundravajtje administrative bazuar në nenin 15 të VKM nr.862, date 05.12.2007 “ Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

-Mos vendosja e sanksioneve dhe masës administrative me gjobë për shkeljet e konstatuara në vitin 2014 në **20 raste** në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikim e territorit”, konkretisht Neni 82, pika 10 dhe në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, miratuar në datë 31 .07.2014 “Për planifikim dhe zhvillimin e territorit”, Neni 52, pika 1, germa “g”.

- Për mos zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”,

-Mos mbajtja e procesverbaleve gjatë çdo kontrolli ka sjellë mos marrjen e masave administrative kundrejt shkelësve të legjislacionit në fuqi

11. zj.N.B. në cilësinë e Kryetares së KVO-së(ish Komuna Lekaj)

-Ofertuesi “N...K” më datë 07.05.2015 i ka dërguar shkresë Komunës Lekaj dhe KVO-së, ku bën sqarimet përkatëse lidhur me ofertën e paraqitur prej tyre, gjithsesi bazuar në shkresën e sipër përmendur, subjekti edhe pse i plotëson kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, *nuk jep një analizë të mirëfilltë kostoje si dhe prova konkrete të detajuara, të cilat të vërtetojnë ofertën e paraqitur prej tyre,* veprim i cili ngarkon me përgjegjësi KVO-në, në kundërshtim me pikën 5, neni 66 , kreu VI, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” dhe kreun IV, neni 56 pika 1(a) dhe 1(b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin Publik

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, por duhet të njoftohet DAP lidhur me rekomandimin që KLSH do të kishte dhënë nëse do të ishin ende në marrëdhënie pune.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “*Largim nga shërbimi civil*” apo “*Zgjidhje e kontratës së punësimit*” **përkatësisht;**

z.I.X. në cilësinë e ish Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, Bashkia Rrogozhinë.

zj.L.M. në cilësinë e anëtarit të KVO-së, ish Komuna Lekaj

z.G.SH. në cilësinë e anëtarit të KVO-së, ish Komuna Lekaj

Shënim: Në vlerësimin e kryer mbi zbatimin e standardeve dhe cilësinë e auditimit, puna e kryer nga grupi i auditimit, vlerësohet shumë e dobët nga Kryetari i KLSH, dhe kjo dosje do të kalojë në kontroll në të ftohtë, për një rivlerësim dhe rishikim të pikave të programit, që nuk janë realizuar plotësisht, si dhe nëse do jetë nevoja do të kryhet auditim në një kohë të dytë, me grup tjetër audituesish shtetëror.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko-financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Rrogozhinë, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Rezart Golemaj, Irma Shkupi, Rajmond Koçi dhe Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT